



## Ministrja Ekonomi në Stamboll, fton bizneset turke për të investuar në Shqipëri



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Znj. Milva Ekonomi ka ftuar bizneset turke të investojnë në Shqipëri gjatë një forumi ekonomik mes dy vendeve, që u zhvillua në Stamboll në 27-28 Janar 2017. “Turqia ka qenë dhe mbetet partner strategjik për Shqipërinë në rajon dhe më gjerë. Por marrëveshja e tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe Turqisë garanton një bazë të mirë ligjore për të zgjeruar marrëdhëniet tregtare dhe për të rritur potencialet për investime të reja” tha Ministrja Ekonomi në fjalën e saj në këtë forum. Ajo shtoi se aktualisht janë 453 biznese turke që operojnë në Shqipëri, në disa sektorë të ekonomisë, kryesisht në sektorin bankar, telekomunikacion, edukim, shëndetësi dhe sektori i energjisë. Ndërsa stoku i investimeve direkte turke në tremujorin e tretë të 2016 ishte 485 mln euro krahasuar me 451 milion euro për të njëjtën periudhë të 2015. Ministrja Ekonomi në vijim njohu investitorët turkë dhe me situatën ekonomike të Shqipërisë, duke shpjeguar se rritja ekonomike në 2016 ishte nga më të lartat në rajon, me një rritje të 3.4 % krahasuar me 2.6 % në 2015. Papunësia është ulur, ndërkohë që klima e biznesit është përmirësuar. Ajo shtoi se Shqipëria ka një kapital njerëzor shumë konkurrues që tërheq investitorët e huaj, ka kosto të ulët të punës dhe cilësi të lartë forcës punëtore, të mirëedukuar në fusha si IT apo inxhinieri. Ministrja përmendi disa sektorë potencialë ku mund të investohet si energjia, minierat, turizmi, bujqësia, transporti, inovacioni etj. Kryesisht në sektorin e turizmit, ajo ftoi bizneset turke që të vijnë dhe të implementojnë modelat e tyre të suksesit veçanërisht në industrinë e strukturave akomoduese.

## Ministrja Ekonomi, takim me donatorët e turizmit: Projektet për turizmin të jenë të koordinuara



Në datë më 23 janar 2017 u organizua takimi i dytë me donatorët për sektorin e turizmit, i cili u drejtua nga Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Znj. Milva Ekonomi. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga organizata të ndryshme ndërkombëtare: EUD, IFC, Bashkëpunimi Italian për Zhvillim, BERZH, Ambasada Gjermane në Tiranë, Ambasada e Zvicrës etj. Në fjalën e saj hyrëse, Ministrja Ekonomi informoi donatorët për aktivitetet më të fundit në fushën e turizmit gjatë këtij muaji, pikërisht për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairët Utrehtit, Shtutgartit dhe Madridit, të cilat i cilësoi të suksesshme për promovimin e turizmit shqiptar. Në vijim ajo bëri një përmbledhje të punës së realizuar gjatë 2016 në kuadër të turizmit duke theksuar faktin që 2016 ka qenë një vit shumë i suksesshëm për turizmin. Ministrja Ekonomi përmendi gjithashtu edhe 2 thirrjet që ka bërë MZHETTS për projekte, thirrje (thirrja e parë në fund të qershorit dhe thirrja e dytë në mes të muajit tetor) të cilat ishin të hapura dhe në përputhje me rregullat e shtetit shqiptar. Gjatë këtij takimi u prezantua dhe Strategjia për Zhvillimin e Turizmit 2017-2022, e cila pritet të miratohet së shpejti. Gjithashtu u paraqit dhe inventari i gjithë projekteve të donatorëve të turizmit, dhe iu bë thirrje për përditësimin e informacioneve të tyre që t'ia paraqesin ministrisë. Ministrja Ekonomi theksoi se komunikimi dhe koordinimi mes gjithë institucioneve apo grupeve të interesit që merren me turizmin është mënyra më e mirë për të prodhuar projekte të përbashkëta që shkojnë në të njëjtën linjë me objektivin e Qeverisë për të zhvilluar këtë sektor të rëndësishëm për Shqipërinë. Takimi u karakterizua nga një interesim aktiv nga ana e organizatave ndërkombëtare të cilat shprehën vlerësimet për punën dhe përpjekjet e ndërmarra nga ministria për promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit të vendit. Takimi i radhës me donatorët e turizmit do të mbahet në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti.

---

## Ministrja Ekonomi takoi Presidentin e Këshillit të biznesit Shqiptaro-Turk



Në një intervistë për emisionin “Presa Diretta” të kanalit RAI 3, në Itali ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, shprehet se Italia mbetet partneri më i rëndësishëm tregtar i Shqipërisë. Gjatë intervistës ministrja thekson se rritja ekonomike është e qëndrueshme. “Ne kemi bërë gjithçka për të stabilizuar situatën ekonomike në vend. Për të gjitha vendet e Ballkanit ideja është që të jenë pjesë integrale e Evropës”, shprehet ndër të tjera ministrja. Pyetjes së gazetares se sa ka ndikuar raporti i Italisë me Shqipërinë në rritjen ekonomike të vendit, ministrja Ekonomi ju përgjigj: “Ka qenë shumë e rëndësishme, sepse në Itali ka shumë shqiptarë që janë emigrantë, ashtu siç janë edhe në Greqi apo në Amerikë, të cilët kanë bërë gjithçka për të sjellë të ardhurat që fitojnë andej, për të mbajtur familjet e tyre që jetojnë këtu. Një tjetër fakt i rëndësishëm është edhe rëndësia e tregut italian që ne zhvillojmë këtu. Italia, mbetet partneri më i rëndësishëm tregtar i Shqipërisë. Janë 3 mijë kompani italiane, që kanë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Rreth 4.5% e investimeve të huaja në Shqipëri janë nga Italia. Sfida më e rëndësishme e Shqipërisë është stabiliteti ekonomik si dhe ulja e papunësisë, për të bërë të mundur që qytetarët të kenë një jetë më të mirë”. Emisioni i ka kushtuar një hapësirë të konsiderueshme një reportazhi për shqiptarët e Italisë dhe për arritjet e tyre profesionale. Komuniteti i madh prej më shumë se 500 mijë shqiptarëve që jetojnë në Itali dhe niveli i lartë i integritetit të tyre konsiderohet si një nga shembujt më pozitiv sot në arenën italiane dhe jo vetëm. Emisioni tregoi dhe histori të suksesshme të rikthimit të emigrantëve shqiptarë, të cilat ndërthuren me ndryshimet rrënjësore që ka pësuar vendi dhe në veçanti Tirana.

### Çertifikimi i udhërrëfyesve turistikë, dorëzimi i dokumentacionit brenda 6 shkurtit



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes fton të gjithë të interesuarit që duan të pajisen me çertifikatën e udhërrëfyesit turistik të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 6 shkurt, ora 14:00, pranë MZHETTS. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, aplikuesit do t'i nënshtrohen një testimi për vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të tyre. Shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë këto kushte për licencimin: të jenë mbi moshën 18 vjeç; të ketë mbaruar arsimin e mesëm; të mos ketë qenë i dënuar me heqje lirie për vepra penale të kryera me dashje; të jetë i pajisur me dokumentin që vërteton përfundimin me sukses të programit përkatës për kualifikimin e udhërrëfyesit. Ligji i ri i turizmit njih tri kategori udhërrëfyesish: lokalë, kombëtarë dhe të specialiteteve të veçanta. Në linkun më poshtë do të gjeni të dhëna mbi dokumentet dhe afatet që duhen ndjekur:

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/njoftim-per-certifikimin-e-udherrefyesve-turistike-dokumentet-dhe-afatet&page=1>

## MZHETTS ofron 5 grante prej 489.090 Lekësh



MZHETTS në kuadër të projektit “I4TOUR - Zhvillimi Territorial për Turizmin e Qëndrueshëm, Ndërmarrjet Krijuese, Zhvillimi Rural dhe Punësimi i të Rinjve” i financuar nga IADSA (Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim), çel thirrjen e dytë për dhënien e granteve mbështetëse për sipërmarrjet kreative të planifikuara për tu ngritur bazuar në ide inovative. Nëse keni një ide kreative në sektorin e turizmit, ju mund të ktheni atë në një sipërmarrje të mirëfilltë, duke përfituar nga grantet mbështetëse që ofron Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Nëpërmjet kësaj nisme krijohet mundësia më e mirë për të transformuar një ide inovative në një sipërmarrje të mirëfilltë, duke ofruar një grant mbështetës, ambientet e punës, si dhe një asistencë të kualifikuar për zhvillimin e idesë, ku do të financohen 5 grante, prej 489.090 Lekë për Start-Up biznesesh në sektorin e turizmit në qarkun e Vlorës. Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë faqen e web-it të projektit I4TOUR [www.i4tour.info](http://www.i4tour.info) duke shkarkuar formularin e aplikimit si dhe guidën shoqëruese të formularit të aplikimit. Afati kohor për pranimin e aplikimeve do të jetë 30 ditë nga data e publikimit.

### Thirrje për projekte

Në kuadër të programeve të BE, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrje njofton hapjen e dy thirrjeve të reja për projekt propozime me fokus në fushën e turizmit dhe integrimin social-ekonomik të të rinjve.

**Thirrja e parë** përmes ‘Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri – Kosovë (2014 – 2020)’ ku janë parashikuar 2,040,000 Euro për financimin e projekteve që synojnë me përparësi zhvillimin e turizmit, të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe integrimin social-ekonomik të të rinjve nëpërmjet investimit tek të rinjtë, edukimi dhe aftësitë.

**Thirrja e dytë** është përmes programit EUSAIR, ku janë parashikuar 1,500,000 Euro për financimin e projekteve që synojnë krijimin e rrugëve transnacionale që ndërlidhen me atraksionet turistike në zonat bregdetare të vendeve, zhvillimin e një strategjie afatgjatë për rrugën detare, konsultimin me aktorë relevantë për projektimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rrugës detare dhe produkteve që lidhen me të, ngritjen e një mekanizmi për bashkëpunim mes aktorëve të ndryshëm në zinxhirin e vlerës së turizmit.

Për më shumë informacion dhe për mënyrën e aplikimeve klikoni në:  
<http://www.ekonomia.gov.al/al/projekte/thirrjet-calls>

## Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

1. DPS ka publikuar standardin SSH EN 15502-1:2012+A1:2015 “Kaldaja për ngrohje me djegie gazi - Kërkesat e përgjithëshme dhe provat”.


### Qëllimi i standardit

Ky standard specifikon kërkesat dhe metodat e provës që kanë të bëjnë, në veçanti, me prodhimin, sigurinë, përshtatshmërinë me qëllimin dhe përdorimin racional të energjisë si dhe klasifikimin dhe markimin e kaldajave me gaz për ngrohje qendrore të pajisura me djegës (bruçator) atmosferik, djegës atmosferik me ventilim të ndihmuar nga djegës plotësisht me parapërzjere të përcaktuar në standard si kaldaja.

2. DPS ka publikuar standardin SSH EN 1870-17:2012+A1:2015 “Siguria e makinave të përpunimit të drurit - Sharrat disk - Pjesa 17: Makina me një disk për prerje tërthore në mënyrë manuale”.

### Qëllimi i standardit

Ky standard trajton të gjitha rreziqet e mundshme, situatat dhe ngjarjet e rrezikshme të cilat janë të lidhura me tronkatriçet me dorë të pa lëvizshme dhe të lëvizshme me prerje horizontale me një disk që më poshtë do të quhen “makina” të projektuara për prerjen e drurit të plotë, panelave të presuar, panelave prej fibre ose kompesate edhe materialeve të veshur me laminat ose me bordur të plastifikuar, kur përdoret në përputhje me qëllimin dhe kushtet e parashikuara nga prodhuesi.



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: [zmp@ekonomia.gov.al](mailto:zmp@ekonomia.gov.al)

Web: [www.ekonomia.gov.al](http://www.ekonomia.gov.al)

